



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo

Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III
Sesioni pranveror

Komisioni i Shëndetësisë, i Punës dhe i Mirëqenie Sociale
Mbledhja nr. 53
Prishtinë, më datë 26 janar 2010, ora 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

PROCESVERBAL

**I MBLEDHJES SË KOMISIONIT TË SHËNDETËSISË, TË PUNËS
DHE TË MIRËQENIES SOCIALE**

Në mbledhje morën pjesë: Sadik Idriz, Rita Hajzeraj, Mursel Halijli, Teuta Hadri, Gjylnaze Syla, Qamile Morina, Flora Brovina, Bujar Bukoshi dhe Nurishahe Hulaj.

Të pranishëm: Nga Zyra e Komisioneve të Kuvendit, Shpresa Haxhijaj - administratore dhe Fatime Qorri - zyrtare ligjore, Driton Selmanaj – KDI dhe Blerim Vela – OSBE.

Mbledhjen e kryesoi: Sadik Idriz, kryetar i Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite

- 1. Miratimi i rendit të ditës,**
- 2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 12 janar 2010,**
- 3. Shqyrtimi i Projektligjit për produkte dhe pajisje medicinale, para miratimit në parim,**
- 4. Miratimi i Raportit vjetor të punës së Komisionit,**
- 5. Shqyrtimi i Planit të punës së Komisionit për vitin 2010,**
- 6. Shqyrtimi i Propozimplanit të veprimit të Kuvendit për integritet evropian,**
- 7. Të ndryshme.**

Kryesuesi konstatoi se ishin plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 12 janar 2010

Kryesuesi konstatoi se Komisioni i Shëndetësisë, i Punës dhe i Mirëqenies Sociale e miratoi procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 12 janar 2010, pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Projektligjit për produkte dhe pajisje medicinale, para miratimit në parim

Sadik Idriz – Projektligji për produkte dhe pajisje medicinale, është i ri. Edhe pse ekziston një ligj, që e rregullon këtë fushë, Ministria e Shëndetësisë e ka proceduar këtë Projektligj të ri. Propozoj që ai të miratohet në parim. Në seancë plenare secili nga anëtarët le të deklarohet në kuadër të grupeve të veta parlamentare. Hap diskutimin.

Rita Hajzeraj – Përkrah Projektligjin, në parim, duke pasur parasysh fushën shumë specifike që e rregullon. Nëse konsiderohet se ligji aktual është dashur të ndryshojë më se 50%, patjetër duhet të bëhet një ligj i ri. Propozoj veten kryesuese të grupit të punës, që do të merret me shqyrtimin e Projektligjit. Nuk e shoh të arsyeshme që Komisioni ta refuzojë atë në leximin e parë.

Gjynaze Syla – Në radhë të parë ne si Komision duhet të kërkojmë shpjegime se çka nuk ka funksionuar në ligjin e mëparshëm dhe pse ka lindur nevoja për një ligj të ri, pra cila është arsyeja që ne po bëjmë një ligj të ri. Nuk mund të mbështes një projektligj, që nuk dallon – nuk është më i mirë se ligji ekzistues. Ka shumë paqartësi rreth AKPM-së. E dimë se ka pasur tensione në AKPM dhe në vend se të qartësohej kjo situatë me këtë Projektligj, nuk është bërë kjo. Nëse qëllimi i Projektligjit është të harmonizohet me legjislacionin e BE-së, prapë kjo nuk arrihet me të.

Qamile Morina – Projektligji, më se 80%, është si ligji aktual. Nëse qëllimi është të na përafrojmë me BE-në, këtë nuk e bënë, përkundrazi na largon. Kriteret që kanë qenë të përcaktuara me ligjin paraprak, me këtë Projektligj parashihet të rregullohen me udhëzim administrativ. Në bazë të kësaj, a mendojmë ne, si Komision, që ky ligj të miratohet në parim?

Nëse e kemi argumentin e vetëm se ky ligj është shumë i rëndësishëm dhe Kosova ka nevojë për të, nuk bën, sepse Kosova e ka një ligj. Fare nuk është bindëse se ky Projektligj është më i mirë se ligji aktual.

Sadik Idriz - Këto pyetje mund t'i bëni në seance plenare, kur ministri ta paraqesë Projektligjin. Gjatë shqyrtimit do ta ftojme ministrin në takim. Ndoshta do të vendosim ta organizojmë edhe një dëgjim publik.

Nurishahe Hulaj – Ne i dimë problemet, të cilat si Komisioni i kemi identifikuar në AKPM. Vërtet ka pasur nevojë për gjëra të reja që të futen në këtë Projektligj. Në grupin e punës kanë marrë pjesë profesionistët farmaceutikë. Në bazë të Kushtetutës të gjitha agjencitë janë të pavarura. Ne më këtë Projektligj mund t'i përmirësojmë gjërat, nëse e parashohim një nen, me të cilin do të rregullohej pavarësinë e AKPM-së, në pajtim me Kushtetutën.

Teuta Hadri – Projektligji do të jetë në diskutim në seancën e radhës. Ministri do të deklarohet pse e ka proceduar një ligj të ri. Ne në kuadër të grupeve parlamentare mund të kemi vërejtje dhe pyetje për ministrin.

Flora Brovina – Ndau mendimin me deputeten Teuta Hadri. Ministri në seancë plenare do ta arsyetojë dilemën pse e ka proceduar një ligj të ri për këtë çështje. Ky Projektligj është i nivelit të ligjit të mëparshëm dhe ka nevojë për shumë amendamente. Sa është i nevojshëm, e kemi parë kur e kemi vizituar agjencinë. Dilema e vetme është: A duhet një ligj i ri apo duhet të bëhet ndryshimi dhe plotësimi i ligjit aktual?

4. Miratimi i Raportit vjetor të punës së Komisionit

Kryesuesi konstatoi se Komisioni i Shëndetësisë, i Punës dhe i Mirëqenies Sociale, njëzëri e nxori këtë

PËRFUNDIM

Miratohet Raporti vjetor i punës së Komisionit për vitin 2009.

5. Shqyrtimi i Planit të punës së Komisionit për vitin 2010

Gjylnaze Syla – Dyshon se agjenda e paraparë për muajin janar do të mund të plotësohet. Tha, se ndoshta do të ishte mirë që disa nga detyrat e planifikuara për janar të barten në muajin shkurt. Propozoi që në gjashtëmujorin e parë të punës së Komisionit të planifikohet edhe mbikëqyrja e një ligji nga lëmi i shëndetësisë, meqenëse Komisioni tash është duke e mbikëqyruar një ligj nga lëmi e punës dhe i mirëqenies sociale. Pjesë e planit të punës duhet të jetë edhe PVPE-ja, sepse ky dokument e ngarkon Komisionin në mënyrë të konsiderueshme. Komisioni e ka për detyrë të raportojë lidhur me përmbushjen e obligimeve, që dalin nga ky dokument. Po ashtu duhet të figurojë një pasues që Plani i punës të pësoj ndryshime.

Sadik Idriz – Tha se Plani i punës është fleksibil. Nuk është planifikuar në gjashtëmujorin e parë mbikëqyrja e zbatimit të asnjë ligji, sepse agjenda e Komisionit për sesionin pranverorë do të jetë shumë e ngarkuar dhe Komisioni tashmë është duke e mbikëqyruar zbatimin e një ligji. Për pjesën e dytë të vitit e kemi planifikuar edhe një mbikëqyrje të zbatimit të një ligji tjetër.

Teuta Hadri – Lidhur me Planin e punës tha se në këtë vit janë paraparë të procedohen ligjet bazike, si të lëmit të shëndetësisë ashtu edhe të lëmit të punës dhe të mirëqenies sociale. Nuk shihet se Ministria ka një plan të vërtetë për ta përfunduar Ligjin për sigurime shëndetësore. Propozoi që në Planin e punës të parashihet raportimi i ministrave në Komision në çdo tre muaj.

Flora Brovina – Tha se për këtë vit janë paraparë ligjet bazikë, që të miratohen dhe për këto ligje kërkohet që Komisionit t'i bashkëngjiten edhe ekspertët. Duhet të punojmë në grupe pune gjatë gjithë ditës. Komisioni ka një shumë të mjetëve. Pse të mos veçohemi diku e të punojmë disa ditë, derisa ta nxjerrim ligjin njëzëri. Në planprogramin e Komisionit duhet të parashihet edhe një tryezë për dialogun social trepalësh.

Rita Hajzeraj - U pajtua me mendimin që të ftohen në takim të dy ministrat, në mënyrë që Komisioni të marrë informata të drejtpërdrejta, se a do të procedohen në të vërtetë këto projektligje bazike në Kuvend. Nga kjo varet shumë edhe Plani i punës së Komisionit për këtë vit. Po ashtu u pajtua me propozimin që në gjashtëmujorin e parë të punës të planifikohet edhe mbikëqyrja e zbatimit të një ligji, si dhe të planifikohen dy dëgjime publike - për Ligjin e punës dhe për Ligjin e sigurimeve shëndetësore, pavarësisht nëse këto dy projektligje do të procedohen ose nuk do të procedohen në Kuvend.

Nurishahe Hulaj – Plani i punës është i mirë. Si Komision duhet të jemi këmbëngulës që të realizojmë gjatë këtij viti. Me ne duhet të jenë edhe ekspertët, të cilët do të na ndihmonin shumë. Në Planin e punës duhet të ceket se një pjesë e punës, e paraparë për këtë vit, është bartë nga viti 2009, punë kjo e papërfunduar, pa fajin e Komisionit.

6. Shqyrtimi i Propozimplanit të veprimit të Kuvendit për integritime evropiane

Sadik Idriz – Sipas Propozimplanit të veprimit të Kuvendit për integritime evropiane, Komisioni ka disa obligime. Për përmbushjen e tyre duhet t'i raportojë Komisionit për Integritime Evropiane. Hap diskutimin.

Gjylnaze Syla – Përmbushja e pikave të parapara me këtë dokument varet nga puna e Qeverisë. Për këtë duhet t'i ftojme në takim të veçantë ministrat, për të parë se ku qëndrojmë me përmbushjen e këtyre pikave. Po ashtu duhet të kërkojmë raport me shkrim nga ministrat për përmbushjen e këtyre obligimeve.

Teuta Hadri – Tha se në vitin e kaluar Komisioni i ka vizituar qendrat mendore. Kemi pasur vërejtje, që i kemi përcjellë në Ministri, por nuk jemi njoftuar nëse po përmbushen kërkesat e Komisionit, mirëpo ne marrim vërejtje nga ndërkombëtarët për mospërmbushje të obligimeve. Sipas Komisionit Qendra Rehabilituese në Shtime ka qenë në nivel. Burgu i Lipjanit ka hapësirë të mjaftueshme, por a shfrytëzohet ajo hapësirë? Kjo nuk është në kompetencë të këtij Komisioni. Me këtë duhet të merret Ministria e Drejtësisë.

Sadik Idriz - Sipas Planit të veprimit, Komisioni për Shëndetësi, së bashku me komisionet e tjera për të drejtat e njeriut, duhet ta organizojë një dëgjim publik. I kemi edhe disa pika të tjera. Ne do t'i përcjellim ministrat se a po i përmbushin obligimet që dalin nga ky Plan. Ne mund ta formojmë një grup pune, i cili do të merret vetëm me çështjet që dalin nga ky dokument gjatë gjithë vitit.

Rita Hajzeraj – Tha se detyrë e Komisionit është t'i pyesë ministrat përkatëse a kanë strategji për dalje nga kjo gjendje. Ministrat janë përgjegjës për përmbushjen e obligimeve, por pse, ne si Komision, të mos i paraprijmë gjërave. Duhet të jemi më këmbëngulës dhe të kërkojmë më shumë llogari nga ministrat përkatëse. Duhet ta nxjerrim një përfundim që në të ardhmen të veprojmë në bazë të tij.

Qamile Morina – Ne duhet të mbledhim të dhëna dhe si Komision të nxjerrim rekomandime. Për të katër pikat që i parashihet ky plan, ne si Komision, së bashku me komisionet e tjera të përfshira, duhet të nxjerrim rekomandime të cilat do t'i procedojmë në seancë plenare. Ajo e obligon Qeverinë të punojë në këtë drejtim.

Nurishahe Hulaj – Plani na obligon që çdo tre muaj t'i raportojmë Komisionit për Integritime Evropiane. Trafikimi me qenie njerëzore, që është në ngritje e sipër dhe dialogu social, janë dy çështje të cilave duhet t'i kushtojmë vëmendje të posaçme. Meqenëse ne i mbulojmë dy ministri, mendoj se duhet të krijohen dy komisione – një komision, i cili do të merret vetëm me çështjet sociale dhe një komisioni, i cili do të merret vetëm me çështjet e shëndetësisë.

Qamile Morina – Propozoi që të formohen dy grupe pune, që do të merreshin me këto çështje. Ato do të raportonin në Komision.

Mursel Halilji – Tha se Plani i veprimit është shumë i qartë. Ne duhet ta bashkërendisim punën me komisionet e tjera, të cilat i kanë për obligim të njëjtat pika, në mënyrë që të shkojmë në rrugë të njëjtë për trajtimin e këtyre çështjeve. Ndoshta nuk është ide e keqe që një grup pune, i këtij Komisioni, të merret me këtë çështje dhe të bashkëpunojë edhe me komisionet e tjera. Të mos përqendrohemi vetëm në institutin e Lipjanit, sepse një institut i tillë mund të jetë edhe diku tjetër.

Flora Brovina – Ndaud mendimin se ky Komision duhet të jetë lider për disa çështje. Në bazë të këtij Plani na janë dhënë disa detyra, të cilat i përkasin këtij Komisioni. Sa i përket trajtimit të shkelësve të ligjit , me te meta mendore, kjo është çështje e këtij Komisioni, që duhet të shohë si trajtohen këta persona, a kanë mundësi shkollimi, punësimi, a ka ndonjë mundësi tjetër të mbajtjes së dënimit dhe të mos e mbajnë dënimin në këtë qendër. Duhet ta pyesim ministrin lidhur me këtë dhe t'i nxjerrim konkluzionet tona. Sa i përket dialogut social, nuk besoj se është çështje e Qeverisë, sepse ne jemi ata që duhet të jemi neutral, meqë ky dialog është trepalësh. Qeveria është vetëm njëra nga palët dhe ne nuk mund t'ia japim përparësinë vetëm njërës palë. Ne jemi fajtorët kryesorë që sindikatat nuk po funksionojnë mirë, si pasoj e mungesë së ligjit. Ne jemi ata që e kemi ndalur Ligjin për lirinë e organizimit sindikal. Përfaqësuesi i punëdhënësve në dialogun social është nga OEK, i cili njëherësh është edhe udhëheqës i Trustit Pensional. Sa i përket trafikimit të qenieve njerëzore , gjithashtu, kemi probleme të mëdha, sepse nuk kemi probleme vetëm me trafikimin, por edhe me rehabilitimin e personave të trafikuar. Ka edhe shumë çështje të tjera, të cilat është dashur të përfshihen në planin e PVPE së si obligime për këtë Komision.

7. Të ndryshme

Flora Brovina – E njoftoi Komisionin për rrjedhën e mbikëqyrjes së zbatimit të Ligjit për Inspektoratin e Punës.

Mbledhja përfundoi në orën 12:20

Përgatiti:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Sadik Idriz